



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

**RAPORTI VJETOR PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË REALIZUAR
NGA MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT PËR VITIN 2023**

1.Përmbledhja ekzekutive *(pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)*

Gjatë vitit 2023, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) ka realizuar 100% procesin e konsultimit publik për projekt-aktet e miratuara, objekt i konsultimit publik sipas përcaktimeve të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Projektligjet e miratuara objekt i konsultimit publik janë:

1. Për disa ndryshime në ligjin nr.91/2013, “Për vlerësimin strategjik mjedisor”.
2. Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9774, datë 12.7.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, të ndryshuar.
3. Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 93/2015, “Për Turizmin”, i ndryshuar

Metodat për konsultimin e këtyre akteve janë përzgjedhur duke marrë parasysh kompleksitetin e akteve dhe implikimet që krijojnë tek qytetarët dhe grupet e interesit.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, të ndryshuar”, është konsultuar me një sërë aktorësh, si pushtetin vendor, qytetarët, bizneset, turizmin, etj., nëpërmjet takimeve konsultative dhe dëgjësës publike me grupet e interesit zhvilluar pranë ambienteve të ministrisë, në datë 16.1.2023. Konsultimi i këtij projektligji është shtrirë në harkun kohor të viteve 2022-2023.

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.91/2013, “Për vlerësimin strategjik mjedisor”, është konsultuar vetëm nëpërmjet Regjistrisë Elektronike të Njoftimit dhe Konsultimit Publik, duke qënë se qëllimi i amendimit të ligjit është unifikimi i procedurave me ligjin nr. 44/20151 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, gjë që nuk sjell risi për subjektet e interesuar dhe ndryshimet nuk prekin thelbin e ligjit nr.91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 93/2015, “Për Turizmin”, i ndryshuar duke qënë se lidhet me sektorin e turizmit, MTM ka organizuar dhe dëgjësën publike me grupet e interesit pranë ambienteve të ministrisë së Sipërmarrjes dhe Klimës së Biznesit në datat 20-21-22 Shtator 2023 ku u diskutua me të pranishmit projektligji, synimet dhe objektivat e tij. Gjithashtu, u dëgjuan me vëmendje komentet dhe sugjerimet e tyre të cilat u trajtuan me shumë prioritet dhe

u reflektuan në draftin e projektligjit, të konsoliduar, ku theksi u vendos kryesisht për marrjen e masave për formalizimin e tregut, lehtësimin e kriterëve dhe procedurave, shtimin e masave administrative etj me synim realizimin e qëllimit të përbashkët, rritjen e standartit në turizëm. Nga monitorimi i platformës së Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK), vihet re se për vitin 2023 ka pasur komente apo rekomandime për disa nga aktet e konsultuara në këtë platformë, të cilat kanë ardhur me postë elektronike dhe shkresë zyrtare pranë MTM-së nga grupet e interesit.

Procesi i Konsultimit Publik krahasuar me vitin e kaluar është përmirësuar, format e përzgjedhura të konsultimit kanë rezultuar efektive duke mundur mbledhjen dhe reflektimin e reaguesve të palëve të interesit në draftin përfundimtar më qëllim krijimin e projektakteve të gjithëpranuar dhe që reflektojnë interesin e publikut.

Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimarrjes nëpërmjet procesit të konsultimit publik mbetet sfida për t'u adresuar edhe më mirë nga MTM, në të ardhmen.

1. Analiza e konsultimeve të kryera

1.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

Numri i akteve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit që i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik gjatë vitit 2023 është 8, konkretisht:

1. Projektligji Për disa ndryshime në Ligjin nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”;
2. Projektligji Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, të ndryshuar”;
3. Projektligji Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 93/2015, “Për Turizmin”, i ndryshuar;
4. Projektligji "Për zbatimin e përgjegjësive të zgjeruara të prodhuesit";
5. Projektvendim për "Miratimin e Planit Kombëtar për menaxhimin e sigurt të kimikateve";
6. Projektvendim Për disa ndryshime në vendimin nr. 417, datë 25.6.2014, të Këshillit të Ministrave “ Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit”;
7. Projektvendim “Pwr disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 419, datë 25.6.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja””, të ndryshuar;
8. Projektvendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 686, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, të ndryshuar”;

Përzgjedhja e tyre është bërë në përputhje me ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Në zbatim të nenit 1, të ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” përcaktohet shprehimisht se ky ligj rregullon procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe projekt dokumentet strategjike kombëtare dhe vendore.

Në zbatim të urdhrin nr. 3, datë 29.1.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e udhëzuesit për procesin e konsultimit publik”, konsultimi publik është parashikuar të realizohet edhe për ato projektvendime të cilat vlerësohen të një interesi të lartë për publikun, pra jo vetëm për projektaktet që kanë detyrimin për t’iu nënshtruar këtij procesi në përputhje me parashikimet e nenit 1, të ligjit të sipërcituar.

1.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Numri i përgjithshëm i akteve të miratuara për vitin 2023 ishte 23 akte.

1.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka konsultuar 8 projektakte për vitin 2023, 4 prej të cilave janë miratuara.

1.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9774, datë 12.7.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, të ndryshuar, është konsultuar me raport të vlerësimit të ndikimit. VNRr nuk aplikohet në rastet e tjera.

1.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përfjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyt kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Nga 23 projektakte, të cilat janë në përputhje me Programin Analitik , për 15 projektakte janë përdorur kriteret/përfjashtimet nga konsultimet publike, ku pjesa më e madhe e tyre është përfjashtuar për kriterin e natyrës individuale të aktit administrativ.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9774, datë 12.7.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, të ndryshuar, është akt që bën pjesë në PKIE dhe është konsultuar.

Nuk ka patur akte të tjera që të jenë pjesë e PKIE-së dhe dokumenteve strategjike.

1.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Struktura e akteve që iu nënshtruan konsultimit publik janë projektligje dhe projektvendime.

1.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?


Krahasuar me një vit më parë, konkretisht me konsultimin në vitin 2022, lidhur me kriteret apo përfjashtimet nga konsultimet publike rezulton se numri i akteve të përfjashtuara nga ky proces është më i ulët, pasi në vitin 2022, kanë qenë të përfjashtuara më shumë akte si akte administrative individuale apo me karakter normativ.

Metodat e konsultimit

1.1.7. Cilat ishjin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Metodat e përdorura për konsultimin publik gjatë kësaj periudhe ishjin konsultimi në faqen zyrtare të regjistrit elektronik për konsultimin dhe njoftimin, posta elektronike, konsultim e këshillim gjatë hartimit të draftit të aktit, tryeza të konsultimit publik pas përgatitjes së draftit të aktit.

Grafik 1: Metodat e përdorura të konsultimit publik



1.1.8. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda që gjeneroi numrin më të madh të komenteve ishte ajo e postës elektronike nga organizatat e shoqërisë civile të cilët zgjedhin që komentet e tyre t'i dërgojnë në adresën e koordinatorit të konsultimit publik apo personit tjetër të kontaktit, sikurse specialist përkatës, përgjegjës për hartimin e projektaktit.

Gjithashtu edhe nga zhvillimi i dëgjësës publike janë gjeneruar një numër i konsiderueshëm komentesh.

1.1.9. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Institucioni ka zhvilluar konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit, për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9774, datë 12.7.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, të ndryshuar.

1.2. Kohëzgjatja e konsultimeve

1.2.1. Sa konsultime ishjin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Për të gjithë projektaktet që i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik për vitin 2023 nëpërmjet publikimit në RENJK, është respektuar afati ligjor prej 20 ditë pune ose edhe më shumë.

Periudha më e gjatë e konsultimit ishte me nga 30 ditë, përkatësisht për projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, projektvendimin “Për Miratimin e Planit Kombëtar për menaxhimin e sigurt të kimikateve” si dhe projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 93/2015, “Për Turizmin”, i ndryshuar.

1.2.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit ka qenë minimalisht një muaj, pra 30 ditë kalendarike, referuar për afatet e publikimit në RENJK të projektaktit.

1.2.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Edhe për këtë periudhë, konsultimi publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) për të gjitha aktet e miratuara gjatë të vitit 2023 u realizua në përputhje me parashikimin ligjor për respektimin e afatit e kohëzgjatjes prej 20 ditësh pune, duke filluar nga data e publikimit.

1.3. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

1 ekspert i jashtëm kontribuoi në draftimin e projektligjit për “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, të ndryshuar”.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Ekspert.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

2.4.4

80 palë të interesuara morën pjesë në konsultime të hapura të realizuara për projekt-aktet.

2.4.5 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

14 prej tyre kontribuan me 39 komente dhe sugjerime, duke ndikuar në hartimin në rritjen e cilësisë ligjeve të krijuara. Struktura e kontribuesve si vijon:

1. Unione dhe shoqata

2. *Organizata të mjedisit*
3. *Njësitë e qeverisjes vendore*
4. *Këshill Konsultativ*

2.4.6 *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara ka ardhur duke u përmirësuar. Kjo gjë konstatohet nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në procesin e konsultimit, të organizuar nga ministria. Gjithashtu, një tjetër tregues rezulton dhe nga monitorimi i faqes së Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, pasi vërehet një rritje e numrit të qytetarëve që ndjekin projektaktet e publikuara në të.

2.5. *Rekomandimet dhe komentet e marra*

2.5.1. *Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?*

Për 3 projektligjet e miratuara, numri i rekomandimeve dhe komenteve është 39.

2.5.2. *Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?*

10 komente u pranuan dhe 26 u refuzuan plotësisht.

2.5.3. *Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?*

Tendenca e pranimit të komenteve dhe sugjerimeve të dhëna nëpërmjet RENJK, takimeve publike apo emaileve mbetet e kënaqshme, pasi shumica e komenteve të marra, është reflektuar.

2.5.4. *Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?*

1 raport, pwr projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9774, datë 12.7.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, të ndryshuar.

2.6. *Raportet mbi rezultatet e konsultimit*

2.6.1. *Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?*

Për të gjitha aktet e publikuara në RENJK, për të cilat afati i konsultimit është mbyllur dhe është bërë vlerësimi i komenteve nga strukturat teknike, institucioni publikoi 3 raporte konsultimi.

2.6.2. *Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?*

Për 3 aktet e konsultuara, janë publikuar raportet përkatëse.

2.7. *Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeks të cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik*

(Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Referuar formatit të kërkuar nga njësia përkatëse në Kryeministri, e cila është hartuar nga MTM shprehemi se indeksi i performancës për cilësinë e konsultimit public, për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit është **8**, për secilin nga projek taktet e miratuara.

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik vazhdojnë të lidhen edhe këtë vit, më së shumti me gjithë përfshirjen e publikut në këtë proces. Sërish nuk reflektohet një kulturë maksimale e angazhimit në proceset e hartimit të politikave, edhe pse ka përmirësime të dukshme.

Në vijim, me qëllim përmirësimit të cilësisë së procesit, synohet ndërgjegjësimi edhe më shumë përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik, në përshtatje me zhvillimet më të fundit të mjeteve të informacionit.